



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
Drejtoria e Prokurimeve

Nr. _____ Prot

Korçë më, 09.12.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Date **09.12.2022**

Drejtuar: **Shoqëria “ INFINIT ”sh.p.k adresa: Korce, Pogradec, Rruga Fan Noli, lagjja 3, nr pasurie 3/167.**

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-49325-11-09-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **Ndërtim i pritave malore në fshatin Neviçisht**

Afati: 1 muaj

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Nr 156 Datë 14.11.2022, Nr.167 Datë 05.12.2022.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i shoqërive „Alb Korça 2002“ sh.p.k NIPT K34004003T dhe „Vildev-Co“ sh.p.k K83926001F me vlerën:

2.068.290 (dy milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

2. Shoqëria “INFINIT” sh.p.k, NIPT J74304623M me vlerën:

2.189.302,5 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dy presje pesë) lekë, pa tvsh.

3. Shoqëria “ARTYKA II” sh.p.k, NIPT K26625603U, me vlerën:

2.343.033 (dy milion e treqind e dyzet e tre mijë e tridhjetë e tre)lek,pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i shoqërive „Alb Korça 2002“ sh.p.k NIPT K34004003T dhe „Vildev-Co“ sh.p.k K83926001F per arsye se:

Ofertuesi nuk ka percaktuar elementet konkretë që merr përsipër te realizojë secili prej anëtarëve të Bashkimit te operatoreve ne kundërshtim me kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e pergjithshme te kualifikimit, ku percaktohet se : *“Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :*

➤ *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.“.*

Per sa më sipër KVO nuk mund të vlerësojë përmbushjen e kriterëve nga secili prej anëtarëve të bashkimit në përputhje me nenin 88 pika te VKM Nr 285 datë 19.05.2021 ku percaktohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqërinë “ INFINIT” sh.p.k, me adresë: Korce, Pogradec, Rruga Fan Noli, lagjja 3, nr pasurie 3/167,** se oferta e paraqitur me vlerë totale **2.189.302,5 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dy presje pesë) lekë, pa tvsh,** është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Korçë, Drejtoria e Prokurimeve, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vijohet sipas parashikimeve të bëra në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**